

SEKSIONI I KATËRT

VENDIM

KËRKESË NR. 54188/08

VJOLLCA CEKANI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur më 23 tetor 2012, duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

George Nicolaou, *president*

Ledi Bianku

Vincent A.De Gaetano, *gjykatës*

dhe Fatos Araci, *zëvendësregjistrues*

FAKTET

1. Ankuesja, Znj.Vjollca Cekani, është shtetase shqiptare, e cila ka lindur në vitin 1952 dhe banon në Gjirokastrë.

2. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga agentja e saj, Znj. L. Mandia e Avokaturës së Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

3. Në vijim të largimit nga puna të kërkueses, më 23 qershor 2008, Gjykata e Apelit Gjirokastrë urdhëroi punëdhënësin e saj, Bashkinë Gjirokastrë, t'i paguajë ankueses pagën e shtatë muajve, nuk u urdhërua asnjë rikthim në pozicionin e mëparshëm të punës.

4. Më 23 tetor 2008 është lëshuar një urdhër përmbarimi. U përllogarit se shuma që duhet t'i paguhej ankueses ishte 800,000 lekë, përveç taksës për përmbaruesin.

Kryerja e procedurave të përmbarimit

5. Me anë të letrës së 24 korrikut 2009, punëdhënësi i ankueses e informoi zyrën e përmbaruesit se kështu e rregullta ishin transferuar në llogarinë bankare të ankueses. Si rrjedhojë, detyrimi prej 400,000 lekë ishte paguar që më 1 dhjetor 2008, ndërsa shuma e mbetur do të paguhej me kështu e rregullta.

6. Më 12 korrik 2010, ankuesja deklaroi me shkrim se iu pagua shuma prej 800,000 lekë.

7. Më 20 shtator 2010, ankuesja kërkoi me shkrim që procedurat e përmbarimit të përfundonin me argumentin se vendimi ishte zbatuar i plotë. Si rrjedhojë, më 21 shtator 2010, zyra e përmbaruesit vendosi t'u jepte fund procedurave të përmbarimit. Vendimi mori formë të prerë dhe asnjë ankimim nuk u paraqiti kundër tij.

B. Ligji dhe praktika e brendshme përkatëse

8. Ligji dhe praktika e brendshme përkatëse janë përshkruar në çështjet Qufaj CO. sh.p.k. kundër Shqipërisë (nr. 54268/00,&& 21-26, 18 nëntor 2004) dhe Gjyli kundër Shqipërisë (nr. 32907/07, && 19-28, 29 shtator 2009).

ANKIMIMI

9. Ankuesja paraqiti ankimim sipas nenit 6&1 të konventës, se vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë i datës 23 korrik 2008 nuk ishte zbatuar.

LIGJI

10. Ankuesja paraqiti ankimim lidhur me moszbatimin e vendimit të formës së prerë në favor të saj.

11. Qeveria pretendoi se vendimi i formës së prerë në favor të ankuesit u zbatua brenda një kohe të arsyeshme.

12. Duke pasur parasysh parimet e përgjithshme që rrjedhin nga e drejta zakonore lidhur me

zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave të brendshme (shih, për shembull, Qufaj Co. sh.p.k., cituar më sipër, & 38; dhe Gjyli, cituar më sipër, & 43-44), gjykata gjykon se ankesa duhet të shpallet e papranueshme si e pabazuar hapur në argumente për arsyet e parashtuara më poshtë.

13. Nga dokumentet rezulton, e pakontestuar nga palët, se autoritetet vepruan me shpejtësi dhe me kujdes për të siguruar pajtimin me gjykimin përfundimtar për borxhin. Për shembull, autoritetet bënë pagesa të rregullta në llogarinë bankare të ankuesit, duke filluar nga 1 dhjetori 2008. Nga 24 korriku 2009, ato kishin shlyer gjysmën e shumës së papaguar. Më 21 shtator 2010, gjykimi për borxhin ishte ekzekutuar në mënyrë të plotë dhe, me kërkesë së ankueses, procedurat e përmbarimit u mbyllën. Për më tepër akoma, gjatë kohës kur u paraqit ankesa, ankuesja paraqiti ankesë lidhur me moszbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendim, i cili, si rrjedhojë, u zbatua në mënyrë të plotë. Asnjëherë gjatë procedurave para gjykatës ankuesja nuk paraqiti ankesë lidhur me kohëzgjatjen e procedurave të përmbarimit, që gjykata nuk i konsideron të papajtueshme me kriteret e “kohës së arsyeshme” sipas nenit 6&1 të konventës (shih, për shembull, Denisov kundër Ukrainës (vend), nr. 18512/02, 1 shkurt 2005; Zhovtan kundër Ukrainës (vend), nr. 170044/02, 22 nëntor 2005’ dhe, *mutatis mutandis*, Kovalenko dhe Boyko kundër Ukrainës (vend), nr. 15066/03, 30 nëntor 2010).

14. Në kuadër të asaj që përmendet më lart, gjykata konkludon se çështja nuk paraqet ndonjë shkelje të nenit 6&1 të konventës. Ajo vijon se ankesa është hapur e pabazuar në argumente dhe duhet të refuzohet në mbështetje të nenit 35&&3 (a) dhe 4 të konventës.

Për këto arsye, gjykata në mënyrë unanime

E shpall ankesën të papranueshme.

Fatoş Araci
Zëvendësregjistrues

George Nicolaou
President